

L I G J
Nr. 8831, datë 22.11.2001

**PËR PRONËSINË SHTETËRORE NË SHOQËRITË TREGTARE FINANCIARE
ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR**

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2015, datë 9.4.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2015, datë 9.4.2015)

1. Ministria e Financave, e përfaqësuar nga ministri, vepron në emër të shtetit dhe është pronare e bankave tregtare shtetërore dhe e institucioneve financiare jobankare.

2. Ministri përgjegjës për ekonominë vepron në emër të shtetit dhe është pronar i shoqërive shtetërore të sigurimit, të cilat janë me kapital tërësisht shtetëror.

Neni 2

Neni 1 i dekretit nr.1430, datë 27.3.1996 “Për një shtesë në ligjin nr. 8033, datë 16.11.1995 “Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre”, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që bie në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3166, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**